

SALI KADRIA

**RAPORTET E BRITANISË SË MADHE ME SHQIPËRINË
GJATË VITEVE 1920-1922**

Marrëdhëniet e Britanisë së Madhe me Shqipërinë paraqesin interes për të parë nga afër, ndikimin që pati kjo fuqi në pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë dhe në zhvillimin e brendshëm të shtetit shqiptar në vitet 1920-1922. Për shkak të rëndësisë së veçantë që paraqesin, ato janë trajtuar në mënyrë të gjerë në studimet historike brenda dhe jashtë vendit.

Ndër autorët e parë që i kushtuan vëmendje ndikimit të diplomacisë britanike në çështjen shqiptare ishte Joseph Swire¹. Pavarësisht, se ai nuk pati për objekt studimin e marrëdhënieve dypalëshe, në punimin e tij, duket ndikimi i qeverisë britanike gjatë periudhës së ngritjes dhe të konsolidimit të shtetit të pavarur shqiptar. Studiuesi Arben Puto, nga vitet 1960 e më vonë, trajtoi gjerësisht rolin që pati qeveria britanike në pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve si dhe në statusin e saj në Konferencën e Ambasadorëve². Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim, dhanë edhe studiuesit Vuk Vinaver, William Bland e Ian Price, të cilët trajtuan aspekte të rëndësishme që lidhen me qëndrimin e mbajtur nga qeveria britanike ndaj Shqipërisë në periudhën midis dy Luftërave Botërore³. Edhe Nicola C. Guy në punimin e saj hedh dritë mbi disa momente të rëndësishme të ndikimit britanik gjatë procesit të zhvillimit

¹ Joseph Swire, *Albania. The Rise of a Kingdom*, London: Arno Press, 1929 (Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: Dituria, 2005).

² Arben Puto, "Problemi i statusit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve në vitet 1920-1921", në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1965; Arben Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: Toena, 2009; Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare (1878-1926)*, Tiranë: Dudaj, 2010.

³ Vuk Vinaver, "Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy luftërave botërore", në *Gjurmime albanologjike*, nr. 2, Prishtinë: 1972; William Bland - Ian Price, *A tangled web. A history of Anglo-American relations with Albania (1912-1955)*, London: Albanian Friendship Society of Southern California, 1986.

të nacionalizmit shqiptar⁴. Studimi më i plotë deri më sot për këtë çështje, është monografia shkencore me titull: “Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927” e studiueses Pranvera Teli (Dibra)⁵. Në këtë studim, përmes burimeve kryesisht britanike, paraqitet në mënyrë autentike, e gjithë panorama e marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe. Autorja trajton propozimet britanike për copëtimin e Shqipërisë në janar të vitit 1920, përpjekjet e kësaj diplomacie për ruajtjen e territorit shqiptar deri në një vendim final ndërkombëtar për Shqipërinë. Gjithashtu, në këtë studim ndiqet me kujdes e gjithë ecuria e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy qeverive deri në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të datës 9 dhjetor 1921.

Për shkak se botimet e kësaj natyre, trajtojnë një numër të madh çështjesh brenda një periudhë të ngjeshur kohore, kjo trajtesë përqendrohet në disa aspekte të veçanta, të cilat mendojmë se do të plotësonin më tej kuadrin e përgjithshëm të studimit të këtyre marrëdhënieve. *Së pari*, do të fokusohemi në sqarimin e kursit politik që ndoqi Britania e Madhe ndaj Shqipërisë gjatë viteve 1920-1921; *së dyti*, do të ndalemi në studimin analitik për çështjen shqiptare, të paraqitur nga John Field, ekspert i Foreign Office-it; *së treti*, në sqarimin e qëndrimit të mbajtur nga diplomacia britanike ndaj Italisë, në fund të Konferencës së Paqes, nëse ai ishte një lëshim që u shoqërua me pasoja për të ardhmen e shtetit shqiptar dhe pranisë britanike në Shqipëri.

Konferenca e Paqes në Paris nuk u dha zgjidhje çështjeve të statusit dhe të kufijve të Shqipërisë. Në këto rrethana, vendimi pritej të merrej nga Konferenca e Ambasadorëve në Paris dhe nga Lidhja e Kombeve. Për këtë arsye, sigurimi i njohjes “de jure” dhe “de facto” të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare si dhe zhblokimi i hyrjes së qeverisë shqiptare në marrëdhënie diplomatike dypalëshe me qeveritë e tjera vazhduan të mbeteshin shqetësim për qeverinë shqiptare.

Në janar të vitit 1920, Aubrey Herbert sillte në vëmendjen e lordit Curzon, idenë se shqiptarët duhej të kishin shtetin e tyre të pavarur. Ndër argumentet kryesore në mbështetje të kësaj pikëpamjeje, ai theksonte luftërat për liri të shqiptarëve; masakrat e kryera ndaj tyre nga ushtritë ballkanike; copëtimin e rëndë të trojeve shqiptare më 1913; tolerancën

⁴ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë – Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, Tiranë: Pegi, 2012.

⁵ Pranvera Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze (1919-1927)*, Tiranë: Ada, 2006.

fetare të shqiptarëve si dhe përhapjen e “një feje të katërt në Shqipëri, asaj të patriotizmit”⁶. Më 24 shkurt 1920, delegacioni shqiptar që gjendej në Konferencën e Paqes në Paris i drejtoi një letër kryeministrit britanik Lloyd George me të cilën e informonte për mbajtjen e Kongresit të Lushnjës, krijimin e qeverisë së re kombëtare, synimin që Shqipëria të mbetej e pavarur, brenda kufijve të vitit 1913 dhe qëndrimin e shqiptarëve kundër çdo mandati apo protektorati të huaj⁷.

Njohja zyrtare e shtetit shqiptar pas mbarimit të luftës, u përcaktua nga diplomacia britanike, si një produkt që do të dilte nga një forum ndërkombëtar. Politika e jashtme e ndjekur nga Britania e Madhe duhej të ishte në harmoni me qëndrimin e fuqive të tjera aleate. Gjithashtu, kjo çështje do të kushtëzohej nga dy faktorë të rëndësishëm: së pari, interesat britanike në Shqipëri dhe politika që ndiqte qeveria britanike në rajon dhe së dyti, shkalla e zhvillimit dhe konsolidimi i brendshëm i shtetit shqiptar.

Nëse shihet me kujdes politika e ndjekur nga qeveria britanike ndaj Shqipërisë, nga mbarimi i Luftës së Parë Botërore deri në vitin 1921, qëndrimi i saj duket se ndoqi dy linja veprimi. Linja e Foreign Office, vazhdonte të mbante një qëndrim të ftohtë ndaj Shqipërisë. Lordi Balfour që mbante detyrën e sekretarit britanik të Shtetit, deklaroi në vitin 1918 se “marrëveshjet e arritura në vitin 1913, në të cilat Shqipëria nuk ishte palë, kanë pushuar së ekzistuari dhe se çështjet më të rëndësishme për Shqipërinë do të vendoseshin nga Konferenca e Paqes”⁸.

Një linjë më dashamirëse ndaj çështjes shqiptare ndoqën përfaqësuesit e misionit të zbulimit britanik në bregdetin e Adriatikut, që vareshin nga War Office (Ministria e Luftës). Përfaqësuesit kryesorë të këtij misioni ishin: Koloneli Aubrey Herbert, William Eden, të cilët vepruan në Shqipëri, ndërsa majori Harold Temperley koordinonte veprimet në Ministrinë e Luftës. Nga ecuria e ngjarjeve të mëvonshme, duket se ata kishin një ndikim të fortë tek drejtuesit e qeverisë britanike.

⁶ *Miku i madh i shqiptarëve. Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme*, Ditarë dhe letra (1904-1923), përgatitur nga Bejtullah Destani dhe Jason Malcolm, përkthyer nga Kastriot Myftiu, Tiranë: Via Egnatia, 2012, f. 332-333.

⁷ *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920*, Përmbledhje dokumentesh, vëllimi II, përgatitur nga Muin Çami, Hidajete Luga (Bejtja), Dhimitër Andoni, Mediha Shuteriqi dhe Zekeria Rexha, Tiranë: 1976, dok. 90, f. 128.

⁸ *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), Foreign Office (më tej: FO) 371/5726. Memorie e H. Temperley, FO, 14 prill 1921.

Gjatë viteve 1915-1918, misioni i zbulimit britanik veproi në Vlorë dhe Korçë, ndërsa në periudhën 1919-1920 përfaqësuesit e tij u vendosën në Durrës dhe Shkodër. W. Eden punonte njëkohësisht për Ministrinë e Luftës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe. Gjatë viteve të luftës, ky mision i dërgonte qeverisë britanike, të dhëna sekrete rreth veprimtarisë së trupave armike, ndërsa pas luftës, informonte lidhur me qëndrimin e autoriteteve italiane në Shqipëri.

Qeveria italiane e konsideroi të rrezikshme praninë britanike në Shqipëri, pasi pengonte planet e saj në Mesdhe. Për këtë arsye, britanikët filluan të trajtoheshin në mënyrë të vrazhdë nga drejtuesit e rinj ushtarakë italianë. Pas zëvendësimit të gjeneral G. Ferrero-s me Settimio Piacentini-në, në tetor 1918, A. Herbert u shprehu prerë eprorëve të tij mendimin se “italianët nuk na duan më këtu (Shqipëri)...”. Në këto rrethana, W. Eden u vendos në Shkodër, ku bashkëpunoi me gjeneralin britanik George Fraser Phillips, i cili gëzonte reputacion në mesin e rretheve kombëtare shqiptare⁹. Sejfi Vllamasi në kujtimet e tij na sqaron se Eden luajti një rol të rëndësishëm në nxitjen e nacionalistëve shqiptarë për organizimin e një kongresi, i cili do të formonte një qeveri kombëtare në vend të qeverisë së Durrësit, vegël e Italisë¹⁰. Pas mbajtjes së Kongresit të Lushnjës, marrëdhëniet e autoriteteve italiane u acaruan me nacionalistët shqiptarë. Në këto kushte, qeveria britanike vendosi të tërhiqte nga Shqipëria Eden-in. Në mars të këtij viti, u largua edhe gjenerali G. F. Phillips¹¹.

Natyrshëm shtrohet pyetja: Përse përfaqësues të shërbimit sekret britanik mbajtën një qëndrim më të favorshëm ndaj Shqipërisë? Megjithëse në dokumentet e Foreign Office nuk gjenden të dhëna të qarta, disa prej tyre, na drejtojnë tek interesat e kompanisë “Anglo-Persian Oil” për shfrytëzimin e fushave naftëmbajtëse në Shqipëri. Kjo kompani filloi negociatat me qeverinë shqiptare gjatë vitit 1920. Bisedimet dypalëshe çuan në marrëveshjen e parë paraprake të arritur në

⁹ *Po aty*, FO 371/3571/132899. Shënime të Eric F. Adam në Protokollin e Foreign Office, 24 shtator 1919; *po aty*, FO 371/3571/143125. George F. Phillips për Drejtorinë e Shërbimit Intelgjent (Directorate of Military Intelligence) në War Office, 1 tetor 1919; *po aty*, FO 371/3571/143125. George F. Phillips për Drejtorinë e Shërbimit Intelgjent në War Office, 14 nëntor 1919.

¹⁰ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Kujtime dhe vlerësime historike, botim i dytë, Tiranë: Neraida, 2000, f. 177.

¹¹ *Miku i madh i shqiptarëve...*, f. 285, 309, 359.

janar 1921¹². Edhe J. Swire dhe studiuesi A. Puto pohojnë se më 20 mars 1920, qeveria britanike ngarkoi Harry C. A. Eyres me një mision special në Shqipëri. H. Eyres premtoi se në këmbim të dhënies nga qeveria shqiptare të koncesionit të naftës në Shqipëri për kompaninë “Anglo – Persian Oil”, qeveria britanike do të mbështeste pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve¹³.

Me interesat e kësaj kompanie duket se ishte i lidhur W.M.F. Eden, i cili edhe pas largimit nga Shqipëria, ruajti bashkëpunimin me përfaqësuesit e qeverisë shqiptare. Ai botoi në Londër, në vitin 1920, një libërth me titull: “*Albania: Its Discontents and their Origin*”. Gjithashtu, majori Julian Barnes ishte angazhuar drejtpërdrejtë në sigurimin e monopolit të duhanit dhe mbrojtjes së interesave britanikë të naftës në Shqipëri. J. Barnes së bashku me Sir Harold George Nicolson, funksionar i lartë në Foreign Office u morën me çështjen shqiptare gjatë Konferencës së Paqes. J. Barnes do të bashkëpunonte edhe me major Harold Temperley në projektimin e kufijve të shtetit shqiptar gjatë verës së vitit 1921. Shumica e britanikëve të lartpërmendur ishin anëtarë të Shoqatës Anglo-Shqiptare dhe mbanin poste të rëndësishme në strukturat e qeverisë britanike. Në artikullin e tij shkencor, Lampros Psomas, shprehet se nuk është jashtë logjikës, të mendohet se W. Eden u dërgua në Shqipëri nga një grup i interesuar dhe kjo ishte kompania “Anglo-Persian Oil”. Kjo kompani synonte shmangien e aneksimit të zonave naftëmbajtëse në viset jugore të Shqipërisë nga shtetet fqinjë, në mënyrë që ato të mbeteshin pjesë e shtetit shqiptar¹⁴.

Nga viti 1920, qeveria britanike filloi të ndryshonte qëndrimin e saj ndaj Shqipërisë nën ndikimin e disa faktorëve të rëndësishëm. *Së pari*, qeveria britanike kishte të dhëna për ekzistencën e burimeve të konsiderueshme të naftës në Shqipëri. Meqenëse politika britanike

¹² Lampros Psomas, “A spy in Albania: Southern Albanian Oil and Morton Frederic Eden”, në *International Journal of Intelligence and Counterintelligence*, Vol. 28, Iss. 3, 2015. Gjendet në:

<http://www.academia.edu>

/12399538/A_Spy_in_Albania_Southern_Albanian_Oil_and_Morton_Frederic_Eden
(Faqja është shikuar më datë 13. 02. 2018, ora 10:50).

¹³ W. Bland – I. Price, *A tangled web. A history of Anglo-American relations...*, f. 13; A. Puto, *Shqipëria politike...*, f. 291; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periodha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 171.

¹⁴ L. Psomas, “A spy in Albania: Southern Albanian Oil...”, f. 13-14.

orientohej nga interesat e naftës¹⁵, sigurimi i këtij produkti me vlerë, paraqiste rëndësi më të madhe se sa konsideratat politike në lidhje me barazpeshën e fuqive. *Së dyti*, fuqizimi i Italisë dhe zgjerimi i saj në rajonin e Mesdheut, cenonte interesat britanikë. *Së treti*, forcimi i autoritetit të qeverisë shqiptare dhe i ndjenjës kombëtare te shqiptarët u prit mirë nga qeveria britanike sepse asaj i interesonte që Shqipëria të mund të mbronte veten dhe të mos kthehej në një vend përplasjesh të shteteve fqinjë dhe të ishte burim konflikti në rajon. Ekzistenca e një shteti të qëndrueshëm shqiptar ishte një tampon për të shmangur një përplasje të mundshme të Italisë me Jugosllavinë¹⁶. *Së katërti*, humbja e kryeministrit Venizellos në zgjedhjet e vitit 1920 dhe rikthimi i mbretit Konstandin në Greqi, pak kohë më vonë, nxitën Foreign Office të shtonte mbështetjen e saj për nacionalizmin shqiptar si një alternativë tjetër, pasi dukej se shteti grek mund të mos mbështeste plotësisht interesat britanikë në rajon¹⁷.

Më 2 nëntor 1920, deputeti britanik Aubrey Herbert, kryetar i Shoqatës Anglo-Shqiptare, iu drejtua nënsekretarit britanik të Shtetit, Cecil Bisshopp Harmsworth, duke i kërkuar që qeveria britanike të njihte qeverinë shqiptare, pasi në të kundërt, ky qëndrim do të inkurajonte fqinjët e Shqipërisë për të ndërmarrë sulme ndaj saj. Ai theksonte se, përdërisa ishte në interesin e Britanisë së Madhe ruajtja e stabilitetit në Ballkan, qeveria britanike nuk duhej ta trajtonte Shqipërinë dhe qeverinë e saj si një çështje të nxjerrë jashtë rendit të ditës¹⁸.

Lidhur me çështjen shqiptare, në mesin e funksionarëve të Foreign Office kishte dy rryma mendimi. Një pjesë e rëndësishme e ekspertëve të Foreign Office vazhdonin të shfaqnin skepticizëm lidhur me autoritetin dhe aftësinë e qeverisë shqiptare për të zgjidhur problemet brenda vendit si dhe për të negociuar me qeverinë jugosllave¹⁹. Një pjesë tjetër, mes të cilëve edhe nënsekretari i Jashtëm britanik Cecil B. Harmsworth, mbështetur në informacionet që vinin nga terreni, arritën në përfundimin se qeveria e Tiranës ishte qeveria më efiçente dhe efektive që kishte pasur

¹⁵ *Miku i madh i shqiptarëve...*, f. 362-363.

¹⁶ P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 133, 142.

¹⁷ N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 279-280.

¹⁸ TNA, FO 371/ 4885. Letër e Sir Aubrey Herbert për Cecil B. Harmsworth, datë 22 nëntor 1920.

¹⁹ *Po aty*, FO 371/ 4689. Harold Temperley për C. B. Harmsworth, datë 17 shtator 1920 dhe 10 tetor 1920; P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 118.

deri atëherë në Shqipëri. Mirëpo, ata hezitonin për ndërmarrjen e një hapi të mëtejshëm, pasi mund të ngjallehin dyshime te qeveria italiane dhe ajo jugosllave mbi motivet që kishin shtyrë qeverinë britanike drejt këtij akti. Cecil B. Harmsworth ishte i mendimit që qeveria britanike nuk duhej të shkonte deri aty sa të njihte zyrtarisht qeverinë shqiptare. Megjithatë, ai sugjeroi ndërmarrjen e këtyre hapave: *Së pari*, emërimin e një agjenti britanik në Shqipëri, i cili të akreditohej pranë qeverisë shqiptare; *së dyti*, Foreign Office të informonte qeveritë italiane, franceze dhe amerikane se qeveria britanike gjente arsye të mjaftueshme që t'i akordonte qeverisë aktuale të Shqipërisë një masë të caktuar besimi si dhe t'u propozonte që qeveria shqiptare duhej të njihej "de juro" sapo Fuqitë Aleate të caktonin kufijtë e Shqipërisë²⁰. Ekspertët e Foreign Office mendonin se qeverisë britanike i ishte hapur rruga për të hyrë në lidhje me qeverinë shqiptare pasi më 2 gusht 1920 qeveria italiane kishte nënshkruar një marrëveshje me qeverinë shqiptare.

Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, më 17 dhjetor 1920, ishte akt i rëndësishëm i njohjes kolektive të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare, megjithatë ende ekzistonte një lloj anomalie pasi, ky akt la pa zgjidhur disa probleme të rëndësishme për shtetin shqiptar. Shqipëria ishte pranuar në Lidhjen e Kombeve si anëtare me të drejta të plota, por asnjëri prej shteteve anëtare të Lidhjes së Kombeve dhe Fuqive Aleate dhe Shoqe nuk ndërmori ndonjë hap për ta njohur zyrtarisht qeverinë e saj dhe për të vendosur me të marrëdhënie zyrtare diplomatike. Ndërkohë, marrëveshjet që kishte nënshkruar me qeveritë e Romës dhe të Athinës nuk u konsideruan si njohje nga ana e tyre. Megjithëse pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ripohonte aktet e vitit 1913, mbetej ende pezull çështja e kufijve të shtetit shqiptar pasi Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene dhe Greqia ngulnin këmbë për "rektifikime" në favor të tyre²¹. Lënia hapur e problemeve të mësipërme, mund të çonte situatën deri aty, sa shtetet që nuk kishin marrë pjesë gjatë procesit të votimit për pranimin e Shqipërisë në këtë organizatë, mund të përmbysnin rezultatin e votimit nëse shteti shqiptar do të ndeshte vështirësi në të ardhmen²².

²⁰ TNA, FO 371/ 4885. Shënim i C. Harmsworth në protokollin e Foreign Office, datë 8 nëntor 1920.

²¹ *Çështja shqiptare në Aktet Ndërkombëtare pas Luftës I Botërore (1919-1926)*, përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik nga Prof. Arben Puto, vëll. III, Tiranë: Albin, 2001, f. 66.

²² TNA, FO 371/ 5726. Memorandum i hartuar nga Charles Tufton në FO, [pa datë].

Përfaqësuesit e Foreign Office argumentonin se pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve nuk nënkuptonte njohjen zyrtare të saj. Ata mendonin se kjo e drejtë i përkiste Konferencës së Ambasadorëve pasi të caktonte përfundimisht kufijtë e Shqipërisë. Ky qëndrim kushtëzohej kryesisht për shkak të politikës britanike në mbështetje të interesave të qeverisë italiane dhe jugosllave²³. Më 18 dhjetor 1920, Foreign Office i kërkoi Eyres-it që të nisej sa më shpejt të ishte e mundur për në Durrës, të njoftonte adresën e tij dhe të hynte në lidhje me qeverinë shqiptare. Ai udhëzohej në mënyrë të prerë që të ishte i kujdesshëm dhe të mos e angazhonte qeverinë britanike drejt njohjes zyrtare të kësaj qeverie apo të siguronte drejtuesit e saj për statusin e ardhshëm të Shqipërisë²⁴. Në fund të dhjetorit 1920, qeveria shqiptare njoftoi qeverinë britanike se ajo mirëpriste ardhjen e diplomatit britanik, se do t'i krijonte atij të gjitha lehtësitë e nevojshme si dhe do të njëhte statusin që i ishte akorduar.

Ndonëse në Shqipëri u dërguan përfaqësues diplomatikë, shteti dhe qeveria shqiptare vazhdonte të mos njihej nga Fuqitë Aleate dhe shtetet fqinjë. Kjo çështje linte hapur mjaft probleme të tjera për shqiptarët, si: zvarritja e përcaktimit përfundimtar të kufijve të shtetit shqiptar; pamundësia e qeverisë shqiptare për të hyrë zyrtarisht dhe drejtpërdrejtë në bisedime me qeveri të tjera për të mbrojtur interesat e saj apo të bashkëkombasve të mbetur jashtë kufijve politikë të Shqipërisë, hezitimi i kompanive dhe i firmave të huaja që të hynin në Shqipëri për të kryer investime apo ngurimi i tyre për të lidhur kontrata koncensionare me një qeveri që nuk ishte njohur ende zyrtarisht; kostoja e shtrenjtë dhe vështirësi të shumta në komunikimet postare dhe telegrafike të shqiptarëve me botën e jashtme; pengesa të mëdha krijoheshin për shkak se qeveritë e tjera nuk lëshonin viza për shtetasit shqiptarë që të udhëtonin jashtë shtetit si dhe nuk njihnin pasaportat e lëshuara nga autoritetet shqiptare²⁵. Këto probleme lanë një shije të hidhur dhe krijuan mendimin te shqiptarët se shteti shqiptar dhe qeveria kombëtare nuk merreshin në konsideratë nga shtetet e tjera, Gjithashtu, pranimi në Lidhjen e Kombeve nuk ishte i barasvlershëm me njohjen zyrtare të qeverisë shqiptare.

²³ N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 278-279.

²⁴ TNA, FO 371/ 4886. Lord Curzon i Kedleston për H. C. A. Eyres, FO, 18 dhjetor 1920.

²⁵ A. Puto, "Problemi i statusit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve...", f. 17.

Para kësaj situate të vështirë, drejtuesit e qeverisë shqiptare menduan të gjenin zgjidhjen e duhur. Ata kishin bindjen se pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ishte një akt i rëndësishëm për të ardhmen e shtetit shqiptar, i cili kishte rrëzuar të gjitha pengesat për njohjen e saj e për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike²⁶, duke krijuar terrenin e përshtatshëm për të hedhur hapat e mëtejshëm për konsolidimin e tij në të ardhmen. Drejtuesit e qeverisë shqiptare vendosën t'i kërkonin qeverisë britanike, njohjen zyrtare të Shqipërisë. Kryeministri shqiptar Iljaz Vrioni përmes një letre informonte kryeministrin britanik Lloyd George se meqenëse shteti shqiptar kishte një qeveri përfaqësuese, demokratike, të stabilizuar dhe të pranuar në Lidhjen e Kombeve, qeveria shqiptare dëshironte të vendoste marrëdhënie diplomatike me qeverinë britanike si dhe kërkonte emërimin e një përfaqësuesi britanik në Shqipëri²⁷. Qeveria shqiptare iu drejtua Britanisë së Madhe për mbështetje, jo vetëm se ajo ishte fuqia më e rëndësishme në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare në Evropë e më gjerë, por edhe për faktin se dashamirësia e përfaqësuesve britanikë ishte bërë shkak që Shqipëria të pranohej në Lidhjen e Kombeve.

Harold Nicolson, funksionar i lartë dhe ndër më të shquarit në Foreign Office, shfaqti mendimin se qeveria britanike duhej të shtynte për momentin, marrjen e një vendimi për çështjen e njohjes zyrtare të qeverisë shqiptare. Ai rekomandoi që të lihej pa përgjigje letra e kryeministrit shqiptar. Zvarritja e njohjes së Shqipërisë kushtëzohej nga tre probleme kryesore: së pari, kufijtë e Shqipërisë nuk ishin njohur ende zyrtarisht; së dyti, qeveria shqiptare duhej të nënshkruante një dokument zyrtar për respektimin e minoriteteve; dhe së treti qeveria britanike nuk mund të vepronte pa i paraqitur parlamentit britanik kërkesën për njohje të Shqipërisë, nga i cili nuk ishte e sigurtë nëse mund të merrej një përgjigje pozitive²⁸. Megjithatë, H. Nicolson mendonte se meqenëse shumica e çështjeve ballkanike ishin zgjidhur ose po shkonin drejt zgjidhjes, qeveria britanike nuk mund t'i shmangej kërkesës së Shqipërisë në mënyrë të pafundme. Ai mendonte se njohja zyrtare e qeverisë shqiptare duhej të realizohej pasi të merrej vendimi për çështjet

²⁶ Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, vëll. I, Tiranë: Toena, 2013, f. 413.

²⁷ TNA, FO 371/ 5725. Letër e kryeministrit shqiptar Ilias Vrioni për kryeministrin britanik Lloyd George, Tiranë, 2 janar 1921.

²⁸ *Po aty*, FO 371/ 5725. Shënim i Harold Temperley në protokollin e Foreign Office, 2 shkurt 1921.

shqiptare nga Konferenca e Ambasadorëve²⁹. Edhe Harold Temperley, funksionar i lartë i Foreign Office, mendonte se “çështja e njohjes së Shqipërisë duhej të qëndronte aty ku ishte dhe kërkesa shqiptare të mbetej pa përgjigje”³⁰.

Pavarësisht këtij qëndrimi, në janar të vitit 1921, qeveria britanike vendosi të dërgonte një konsull “pa exequatur” (pa njohje zyrtare) në Shqipëri, që të ndiqte nga afër zhvillimet e brendshme kombëtare shqiptare deri sa të arrihej njohja zyrtare e shtetit dhe e qeverisë shqiptare³¹. Harold Temperley mbronte pikëpamjen se vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, për qeverinë britanike ishte më pak e rëndësishme se sa përcaktimi i kufijve të saj. Megjithatë, edhe ai pranonte se çështja e njohjes zyrtare të qeverisë shqiptare nuk mund të shtyhej pafundësisht nga britanikët³².

Njohja zyrtare e Shqipërisë dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike me qeverinë shqiptare ishin bllokuar nga disa faktorë kryesorë: *së pari*, synimi dhe veprimet e vazhdueshme të shteteve fqinje për t’i shkëputur Shqipërisë pjesë të tjera nga territori i saj; *së dyti*, këmbëngulja e Italisë për të siguruar me çdo kusht njohjen dhe sanksionimin ndërkombëtar të “interesave të posaçme italiane” në Shqipëri; *së treti*, çështja shqiptare ishte pjesë e rëndësishme e interesave dhe e rivalitetit mes Fuqive të Mëdha. Pavarësisht faktorëve negativë, diplomatët britanikë ishin të ndërgjegjshëm se vendimet e viteve 1913 dhe 1920 kishin patur ndikim tek opinioni publik ndërkombëtar dhe kishin krijuar një “rast moral” për ekzistencën e kombit dhe të shtetit të pavarur shqiptar. “Argumenti moral” ishte përforcuar nga akti i pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe fjalimi i përfaqësuesit britanik Fisher i mbajtur me këtë rast³³.

Kërkesa e Shqipërisë për njohjen e saj nga qeveria britanike, ngjalli shqetësim dhe rivalitet tek Italia dhe Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene.

²⁹ *Po aty*, FO 371/ 5736. Shënim i Harold Nicolson në protokollin e Foreign Office, 15 janar 1921.

³⁰ *Po aty*, FO 371/ 5726. Shënim i Harold Temperley në protokollin e Foreign Office, 11 mars 1921.

³¹ *Po aty*, FO 371/ 5725. Notë e FO për të Ngarkuarin me Punë të Francës në Londër, FO, 13 janar 1921; J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie ...*, f. 274.

³² *TNA*, FO 371/ 5726. Shënim i Harold Temperley në protokollin e Foreign Office, 2 prill 1921.

³³ *Po aty*, FO 371/ 5726. Memorandum i hartuar nga John Field në FO, mbi pozicionin aktual dhe politikën e jashtme britanike në të ardhmen, FO, prill 1921.

Diplomatët italianë pyesnin në Foreign Office, nëse qeveria britanike i kishte akorduar qeverisë shqiptare njohjen zyrtare. Ndërkohë, funksionarët e lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene jo vetëm që ishin mjaft të shqetësuar ndaj një njohjeje të mundshme të qeverisë shqiptare nga ajo britanike, por ata nuk kishin “harruar” të shpreheshin ashpër për “gabimin” e pranimin të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe veçanërisht ndaj qëndrimit të mbajtur nga përfaqësuesi britanik lordi Robert Cecil³⁴. Diplomacia e Beogradit ndjente se pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve i kishte dhënë një goditje të fortë planeve të qeverisë serbo-kroato-slllovene. Mirëpo, anëtarësimi i saj në Lidhjen e Kombeve, tashmë ishte një ngjarje e kaluar, për të cilën ishte siguruar një miratim unanim, duke përfshirë edhe votën e përfaqësuesit jugosllav.

Për të patur një njohje më të thellë, mbi qëndrimin që duhej të mbante qeveria britanike kundrejt statusit të Shqipërisë, Foreign Office, ngarkoi ekspertin e saj, John Field, për të hartuar një memorandum mbi çështjen shqiptare. Në përfundim të studimit, ai paraqiti tre variante për qëndrimin që mund të mbahej nga qeveria britanike. Varianti i parë, parashikonte zbatimin e vendimeve të vitit 1913; varianti i dytë, kërkonte zbatimin e vendimeve të Traktatit të Fshehtë të Londrës të vitit 1915; dhe varianti i tretë, parashikonte njohjen zyrtare të Shqipërisë sipas memorandumit të datës 9 dhjetor 1919. J. Field rekomandoi se nëse pranohej varianti i parë, nuk duhej të lihej në harresë mendimi se vendimet ndërkombëtare të vitit 1913 ishin zhvlerësuar nga akte ndërkombëtare të nënshkruara gjatë luftës. Për këtë arsye, ai i rekomandonte qeverisë britanike që të mos shprehej se këto vendime ishin zhvlerësuar në mënyrë automatike, por të përdorej argumenti se Fuqitë e Mëdha dëshironin ta rishqyrtonin edhe njëherë çështjen dhe të paraqisnin modifikime për vendimet e tyre. Sipas tij, kjo mënyrë ishte më pak e komplikuar, sepse sipas traktateve të paqes, Gjermania dhe Austro-Hungaria ishin të detyruara të praninin vendimet e Aleatëve.

J. Field mendonte se nëse zbatohet varianti i Traktatit të Fshehtë të Londrës të vitit 1915, qeveria britanike do të gjendej në pozitën më të vështirë. Edhe qeveria britanike dëshironte t'i shmangej zbatimit të këtij

³⁴ *Po aty*, FO 371/ 5726. Shënim i Harold Nicolson në protokollin e Foreign Office, 20 prill 1921; *po aty*, FO 371/ 5726. Telegram i Sir A. Young për FO, Beograd, 28 maj 1921.

varianti e shtyrë nga disa faktorë kryesorë: së pari, ky variant mund të ngjallte një rivalitet të ashpër mes shteteve fqinjë të Shqipërisë, e cila mund të shkaktonte fillimin e një lufte; së dyti, shpërfillja e interesave kombëtarë të shqiptarëve dhe copëtimi i atdheut të tyre mund të ngjallte reagimin e tyre kombëtar; së treti, sipas Traktatit të vitit 1915, Italisë i njihej sovraniteti i plotë mbi Sazanin, Vlorën dhe territorin përreth saj, mirëpo forcimi i pozitës së Italisë mund të rrezikonte interesat e Britanisë së Madhe në rajonin e Mesdheut. I shtyrë nga këto arsye, J. Field arrinte në përfundimin, se copëtimi i Shqipërisë sipas Traktatit të Londrës të vitit 1915, tashmë nuk kishte vlerë. Një hap i tillë kushtëzohej nga përfshirja e Dalmacisë brenda shtetit italian si dhe nga fakti që Italia kishte hequr dorë “vullnetarisht” nga Vlora. Prandaj, Italia nuk kishte arsye të kërkonte nga qeveria britanike mbajtjen e zotimeve sipas këtij traktati.

Zbatimi i variantit të tretë, sipas memorandumit të arritur më 9 dhjetor 1919, i jepte Italisë “mandatin” e protektoratit mbi të gjithë Shqipërinë. Mirëpo, edhe kjo ofertë ishte zhvlerësuar nga deklarata e kryeministrit italian Giovanni Giolitti më 28 qershor 1920, në parlamentin italian, ku ai shprehej se qeveria italiane nuk mbështeste më idenë e protektoratit italian mbi Shqipërinë. Sipas analizës së diplomacisë britanike, rezultonte se sapo të ndërpriteshin provokimet e jashtme ndaj shqiptarëve, në mesin e tyre do të ringjallej përçarja fetare dhe fisnore deri në atë shkallë sa t’u krijonte vështirësi për një qeverisje të civilizuar, ose mënyra e centralizuar e qeverisjes kombëtare do të rezultonte krejtësisht e pamundur në Shqipëri. Në këndvështrimin britanik, problemi më i madh ishte se shqiptarët nuk kujdeseshin sa duhej për vendosjen e një mënyre qeverisjeje të rregullt, të moderuar dhe të qytetëruar. Imponimi i vendosjes së modelit të qeverisjes së qëndrueshme në Shqipëri, sipas ekspertëve britanikë nuk ishte detyrë e shteteve perëndimore, por vetë shqiptarët duhej të gjenin rrugëdaljen nëse pranonin modelin e qeverisjes kombëtare³⁵.

Në përfundim të kësaj analize, J. Field theksonte se pavarësisht varianteve të paraqitura, deri në dhjetor të vitit 1920, qeveria britanike nuk ishte e lidhur në mënyrë të pazgjydhshme nga ndonjë politikë

³⁵ *Po aty*, FO 371/ 5726. Memorandum i hartuar nga John Field në FO, në lidhje me pozicionin aktual dhe politikën e jashtme britanike në të ardhmen, FO, prill 1921.

definitive ndaj Shqipërisë, prandaj ishte e lirë të merrte vendime në të ardhmen³⁶.

Qëndrimi i Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë u përcaktua në tekstin e memorandumit të datës 14 prill 1921³⁷. Më 15 prill 1921, sekretari britanik i Shtetit, lordi Curzon, pohoi përfundimisht piketat e mënyrës së veprimit, për njohjen zyrtare të Shqipërisë. Sipas arsytimit të tij, procesi i njohjes së Shqipërisë nga Britania e Madhe duhej të kalonte në dy etapa: së pari, duhej të fiksoheshin kufijtë e shtetit shqiptar, të cilat në rrethanat aktuale mund të arriheshin me një marrëveshje ndërmjet Britanisë së Madhe, Francës, Italisë, Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, Greqisë dhe Shqipërisë; së dyti, të njihesh qeveria qendrore e shtetit të ri shqiptar. Ai kërkoi që t'i bëhej rezistencë përpjekjes italiane për të siguruar nga britanikët njohjen e së drejtës së veçantë për të ushtruar një ndikim të përhershëm politik në Shqipëri. Ai iu bashkua propozimit të H. Nicolson që e vetmja mënyrë për arritjen e një marrëveshjeje për çështjet që lidheshin me Shqipërinë ishte mbajtja e një Konferencë të Ambasadorëve të Fuqive Aleate në Paris, e cila të ngarkohej me zgjidhjen e këtyre çështjeve³⁸.

Qeveria shqiptare, përmes delegacionit të saj pranë Konferencës së Paqes, i drejtoi më 29 prill 1921, një kërkesë tjetër qeverisë britanike dhe asaj franceze, në të cilën kërkohej vendosja e marrëdhënieve diplomatike, si një mënyrë praktike, për të sheshuar në një kohë të shpejtë të gjitha pengesat që i nxirrnin asaj fqinjët përmes shkeljeve të tyre³⁹.

Qeveria italiane insistonte që njohja ndërkombëtare dhe përcaktimi i kufijve të shtetit shqiptar, të trajtoheshin nga Fuqitë Aleate në Konferencën e Ambasadorëve që pritej të mbahej në Paris, ku të njiheshin interesat e veçanta të Italisë në Shqipëri. Më 20 prill 1921, për herë të parë u shfaq hapur, ndryshimi i qëndrimit të Foreign Office-it ndaj çështjes shqiptare. Lordi Curzon njoftoi ambasadorin italian De Martino, se qeveria britanike ndante të njëjtën dëshirë me qeverinë italiane, për ruajtjen e pavarësisë dhe të tërësisë territoriale sipas kufijve të qartë për Shqipërinë. Curzon paralajmëroi qeverinë italiane, se Britania e Madhe i rezervonte vetes lirinë e plotë të veprimit, si një nga pjesëmarrëset e

³⁶ *Po aty*.

³⁷ P. Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze...*, f. 142-143.

³⁸ *TNA*, FO 371/ 5726. Shënim i Earl Curzon në protokollin e Foreign Office, 15 prill 1921.

³⁹ A. Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare...*, f. 324.

Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913. Ai theksonte se, megjithëse qeveria britanike nuk kishte asnjë interes politik në Shqipëri, ajo do të përpiqej për ruajtjen e regjimit që do të vendosej në Shqipëri sipas marrëveshjes ndërkombëtare që do të arrihej nga fuqitë⁴⁰.

Britania e Madhe dëshironte që trajtimi i çështjes shqiptare të ndahej në dy pjesë. Konferenca e Ambasadorëve dhe Komiteti i Ekspertëve për Shqipërinë të merreshin kryesisht me caktimin e kufijve të saj, ndërsa caktimi i statusit të këtij shteti dhe pretendimet e Italisë të trajtoheshin në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, ku të dëgjohej edhe zëri i Shqipërisë. Ky ishte një ndryshim nga qëndrimi i saj i mëparshëm, kur i kishte shprehur ambasadorit italian se Konferenca e Ambasadorëve duhej të trajtonte edhe formën e njohjes apo të statusit ndërkombëtar të shtetit shqiptar. Foreign Office sugjeronte se vendimet e Konferencës së Ambasadorëve duhej të pasqyroheshin në një protokoll ose traktat të veçantë⁴¹. Qeveria britanike ishte e ndërgjegjshme, se Italia nuk do të linte gur pa lëvizur që në tekstin e dokumentit, ku përcaktohej statusi ndërkombëtar i Shqipërisë, të përfshinte ndonjë frazë, ku të theksohej lidhja e varësisë së Shqipërisë nga Italia, ndoshta duke u mbështetur te marrëveshja italo-shqiptare e datës 2 gusht 1920. H. Temperley porosiste diplomatët britanikë që merreshin me këtë çështje, se duhej të hapnin sytë për këtë tendencë të Italisë, pasi dëshira e qeverisë britanike deri në këtë moment ishte pavarësia dhe sovraniteti i plotë i Shqipërisë, siç ishte krijuar “de novo” nga pranimi i saj në Lidhjen e Kombeve⁴².

Njohja e Shqipërisë si shtet i pavarur dhe sovran, sipas dy projekt-memorandumeve britanike të datës 12 korrik 1921 të paraqitura në Konferencën e Ambasadorëve, u kundërshtua nga Italia dhe Franca. Përfaqësuesi italian kërkoi që në dokumentin e njohjes të përfshihej pikëpamja e qeverisë italiane për një status të veçantë në Shqipëri. Prandaj, ai kërkoi kohë deri sa të merrte udhëzime nga qeveria e tij për mënyrën se si do të operohej më tej. Përfaqësuesi francez nuk e shfaqti qartë shkakun e kundërshtimit të tij por, me sa dukej qeveria franceze kërkonte të përfitonte koncesione ekonomike në pjesën e Shqipërisë së

⁴⁰ TNA, FO 371/ 5726. Earl Curzon i Kedleston për Signor de Martino, FO, 20 prill 1921.

⁴¹ *Po aty*, FO 371/ 5727. Charles Tufton për Milne Cheetham në Paris, FO, 12 korrik 1921.

⁴² *Po aty*, FO 371/ 5731. Notë e H. Temperley për njohjen e Shqipërisë nga Fuqitë kryesore Aleate, FO, 10 tetor 1921.

Veriut. Përkundër, synimeve të qeverisë italiane, përfaqësuesi britanik kërkoi me insistim që Konferenca e Ambasadorëve të merrte shënim zyrtarisht pikëpamjet e paraqitura nga qeveria britanike, të cilat parashikonin shmangien e prezencës së Italisë në Shqipëri⁴³.

Qeveria britanike paraqiti pikëpamjen e saj për çështjen e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve përmes një memorandumit të hartuar nga Harold Temperley. Teksti i memorandumit britanik përmbante dy linja kryesore. Nga njëra anë, diplomacia britanike iu përmbajt formalisht qëndrimit të mëparshëm që statusi i Shqipërisë i vitit 1913 ishte prekur nga lufta dhe se asnjë angazhim apo garanci e qartë që pranonte ekzistencën e Shqipërisë nuk gjendej në serinë e traktateve ndërkombëtare pas mbarimit të luftës. Mirëpo, nga ana tjetër u paraqitën argumente të tjera, të cilat konfirmonin pavarësinë dhe ekzistencën e shtetit shqiptar. Në këtë dokument vihej në dyshim Traktati i Londrës i vitit 1915, që parashikonte copëtimin e Shqipërisë, pasi ai nuk ishte zbatuar deri atëhere. Po kështu, argumentohej se ky traktat ishte zhvlerësuar, pasi Italia pranoi t'i rikthente Shqipërisë mandatin e saj të protektoratit. Gjithashtu, edhe vlefshmëria e përmbajtjes së Memorandumit franko-britaniko-amerikan i datës 9 dhjetor 1919 dhe i Këshillit Suprem të Aleatëve ishte ndërprerë nga refuzimi i SHBA më 17 shkurt 1920 si dhe nga deklarata e G. Giolitti-t më 28 qershor 1920. Në dhjetor 1920, Shqipëria ishte pranuar në Lidhjen e Kombeve dhe këshilltarët ligjorë të Fuqive kryesore Aleate ishin shprehur se pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve përbënte njohje "de jure" të shtetit shqiptar. Prandaj, memorandumet britanike të datave 12 dhe 20 korrik 1921, theksonin se sipas artikullit 1, të Konventës së Lidhjes së Kombeve, Shqipëria ishte pranuar në Lidhjen e Kombeve si "shtet" pa rezerva mbi pavarësinë e saj dhe jo si dominion apo koloni, prandaj si e tillë, ajo gëzonte pavarësi dhe sovranitet të plotë. Për këtë arsye, pavarësia dhe sovraniteti i Shqipërisë ishin garantuar "ipso facto" nga pranimi i saj si shtet në Lidhjen e Kombeve.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me secilën prej shteteve dhe veçanërisht mbrojtja e minoriteteve racore, ishin çështje që i përkisnin Lidhjes së Kombeve. Deklarata e Mbrojtjes së Minoriteteve, tashmë ishte në rrugën e realizimit nga ana e qeverisë shqiptare. Çështja kryesore shtrohej se cili duhej të ishte niveli i përfaqësimit diplomatik të fuqive në Shqipëri pra, a

⁴³ *Po aty*, FO 371/ 5728. Telegram i ambasadës britanike në Paris për FO, Paris, 23 korrik 1921.

duhej që të vendoseshin misione diplomatike apo thjesht përfaqësi konsullore në Shqipëri dhe nëse njohja zyrtare e qeverisë shqiptare e Shqipërisë si shtet sovran dhe i pavarur, duhej të paraqitej përmes një deklarate të përbashkët apo në mënyrë të pavarur përmes njohjes së veçantë nga secila fuqi.

Italia shfaqti rezerva ndaj përmbajtjes së memorandumit britanik, pasi ajo dëshironte kufizimin e pavarësisë së Shqipërisë. Rezervat e saj, lidheshin me tri çështje kryesore: 1. Italia synonte të siguronte koncesione ekskluzive ekonomike e tregtare në Shqipëri; 2. Ajo kërkonte të siguronte një formulë, e cila të parashikonte që në rast se qeverisja e sotme shqiptare dështonte dhe vendi shkonte drejt anarkisë, qeveria italiane të kishte të drejtën ekskluzive për të ndërhyrë që të rivendosej rendi dhe të kontrollonte këtë vend; 3. Italia synonte realizimin e projektit të saj final, i cili parashikonte zotërimin e Vlorës dhe të ishullit të Sazanit. Edhe Franca paraqiti rezerva, pasi kërkonte koncesione ekskluzive ekonomike dhe tregtare në Shqipërinë e Veriut. Ndërkohë, Greqia e kushtëzonte njohjen e pavarësisë së plotë të Shqipërisë, me pranimin e modifikimeve të kufirit jugor të saj në favor të Greqisë. Në këto rrethana, për pavarësinë e plotë të Shqipërisë ishin në parim, Britania e Madhe, Greqia dhe Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene. Italia dhe Franca kishin rezerva, ndërsa Japonia nuk ishte shprehur ende për qëndrimin e saj⁴⁴.

Fillimisht, diplomacia britanike këmbënguli me forcë kundër “të drejtave speciale” që kërkonte Italia. Drejtuesit e Foreign Office parashikonin se në të ardhmen do të kishte dy probleme të rëndësishme në marrëdhëniet e saj me Italinë: së pari, Italia do të kërkonte që interesat e saj ekonomikë dhe tregtarë të zinin një pozitë “speciale” në Shqipëri. Qeveria britanike e kishte të qartë se edhe nëse i njihje Italisë interesat strategjikë dhe tregtarë në Shqipëri, qeveria italiane do të vazhdonte të shfaqte dyshime të mëdha për çdo ndërhyrje britanike në këtë vend; së dyti, qeveria italiane nuk do të hiqte dorë nga synimi për të mbajtur nën administrimin e saj ishullin e Sazanit dhe Vlorën. Kjo çështje përbënte një shqetësim të madh për qeverinë britanike, pasi ajo ishte kundër idesë që Italisë t’i lihej zotërimi i ishullit të Sazanit apo i ndonjë baze ushtarake në Vlorë. Vendosja e Italisë në këtë pozitë, i jepte mundësi asaj të përzihej në trazirat që mund të ndodhnin në Ballkan në të ardhmen. Për

⁴⁴ *Po aty*, FO 371/ 5729. Memorandum i hartuar nga Harold Temperley, FO, 23 gusht 1921.

këtë arsye, qeveria britanike dëshironte që t'i jepeshin Italisë vetëm garanci për një pozitë të favorshme tregtare në Shqipëri⁴⁵.

Qeveria britanike ishte e vendosur që forma e njohjes së qeverisë shqiptare të pasqyrohej në një dokument të veçantë. Qëndrimi i Britanisë së Madhe në favor të njohjes së pavarësisë së shtetit shqiptar, gjatë punimeve të Konferencës së Parisit, shkaktoi një valë gëzimi në mesin e nacionalizmit shqiptar. Me dhjetëra telegrame falënderimi iu drejtuan konsullit britanik Eyres nga grupe shqiptarësh nga Shkodra, Lushnja, Gjirokastra, Tepelena, Delvina e të tjerë, ku shprehej mirënjohja e shqiptarëve ndaj qeverisë britanike për mbështetjen që u kishte dhënë shqiptarëve. Madje, në telegramin e dërguar nga Shkodra, njohja e kufirit të vitit 1913 quhej “triumf i drejtësisë dhe njohje e jetës politike të kombit shqiptar”⁴⁶.

Më 7 nëntor 1921, Foreign Office i shkruante H. C. A. Eyres, konsullit britanik në Durrës “ju lutemi, njoftoni qeverinë shqiptare se pas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve për kufijtë e Shqipërisë, qeveria britanike njeh qeverinë aktuale shqiptare si qeveri ‘de jure’ dhe ‘de facto’ të gjithë Shqipërisë. Një deklaratë me këtë përmbajtje do të paraqitet sot në Dhomën e Komuneve”⁴⁷. Kryeministri shqiptar i shprehu mirënjohjen delegacionit britanik dhe qeverisë britanike në emër të qeverisë dhe të kombit shqiptar⁴⁸. Akti i fundit i qeverisë britanike, shënonte herën e tretë brenda harkut të një viti që nacionalizmi shqiptar arriti të siguronte mbështetjen e fuqisë më të madhe botërore në mbrojtje të interesave kombëtare të shtetit shqiptar. Në dhjetor 1920, Britania e Madhe mbështeti pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve; në fillim të nëntorit 1921, kryeministri britanik kërcënoi qeverinë jugosllave, se nëse ajo nuk tërhiqte forcat ushtarake nga territori i Shqipërisë, ky akt do të konsiderohej si “agresion” dhe Britania e Madhe do t'i kërkonte Lidhjes së Kombeve zbatimin e sanksioneve sipas Konventës së Lidhjes së Kombeve; më 7 nëntor qeveria britanike njohu zyrtarisht qeverinë shqiptare.

⁴⁵ *Po aty*, FO 371/ 5726. Memorandum i hartuar nga John Field në FO, në lidhje me pozicionin aktual dhe politikën e jashtme britanike në të ardhmen, FO, prill 1921.

⁴⁶ *Po aty*, FO 371/ 5729. H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, 26 gusht 1921.

⁴⁷ *Po aty*, FO 371/ 5733. Telegram urgjent i FO, për H. C. A. Eyres në Durrës, FO, 7 nëntor 1921.

⁴⁸ *Po aty*. Telegram i Eyres për FO, Durrës, 9 nëntor 1921.

Pas insistimit të vazhdueshëm të qeverisë italiane për të siguruar një pozitë të veçantë në Shqipëri dhe në kushtet kur vetëm Britania e Madhe shfaqti kundërshtim ndaj pozitës speciale të Italisë në Shqipëri, pozita e diplomacia britanike rrezikonte të mbetej e izoluar. Në këto rrethana, qeveria britanike pranoi të hiqte dorë nga kundërshtimi. Ky veprim çoi në arritjen e një formule italo-britanike, e cila u miratua nga Konferenca e Ambasadorëve në Paris, më 9 nëntor 1921⁴⁹. Lëshimi britanik pati dy rrjedhoja të rënda për të ardhmen e Shqipërisë dhe të interesave britanikë. Së pari, u cenua sovraniteti kombëtar i shtetit shqiptar, sepse përmbajtja e marrëveshjes italo-britanike, parashikonte që në rast të një sulmi të jashtëm ndaj Shqipërisë, detyra e rivendosjes së pavarësisë dhe e kufijve të saj, t'i besohej Italisë. Ky përcaktim nuk pajtohej me statusin e Shqipërisë si shtet i pavarur. Në këndvështrimin tonë, duket se Britania e Madhe bëri një lëshim të tepruar ndaj Italisë. Ky hap nuk garantonte stabilitetin politik në rajon, i cili ishte i rëndësishëm për interesat politikë të Britanisë së Madhe, pasi ai i hapi rrugë depërtimit të vazhdueshëm të Italisë në Shqipëri, derisa ky vend u pushtua nga Italia në vitin 1939. Së dyti, me këtë veprim, diplomacia britanike i dha një goditje interesave të saj ekonomikë dhe tregtarë në Shqipëri. Në periudhën e mëvonshme, Britania e Madhe ndjeu rivalitetin dhe presionin e vazhdueshëm nga ana e qeverisë dhe kapitalit italian.

Njohja zyrtare e Shqipërisë nga Britania e Madhe dhe vendimi i datës 9 nëntor 1921 i Konferencës së Ambasadorëve nuk u mirëprit nga Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene. Ato u konsideruan si një goditje e Britanisë së Madhe ndaj shtetit jugosllav⁵⁰. Njohja zyrtare shkaktoi furtunë edhe te qeveria italiane. Meqenëse Italia nuk arriti të ndalonte këtë akt të diplomacisë britanike, ajo synoi të pengonte përfaqësimin diplomatik të Shqipërisë me njerëz të aftë. Ambasadori italian në Londër u shpreh negativisht për Mid'hat Bej Frashërin, i cili pritej të ishte përfaqësuesi zyrtar i Shqipërisë në Londër. Ai e cilësonte M. Frashërin si “një intrigant i mirënjohur, i cili synonte të mbillte përçarjen mes Aleatëve”. Në fakt, as funksionarët e Foreign Office nuk kishin ndonjë mendim pozitiv për M. Frashërin, pasi ata parapëlqenin Mehmet Bej Konicën. Për shkak të luftës politike brenda vendit, M. Konica nuk i

⁴⁹ *Po aty*, FO 371/ 5730. Formula e miratuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Paris në lidhje me të drejtat e Italisë në Shqipëri, 9 nëntor 1921; *Nations League, Official Journal*, December 1921, Second year, nr. 12, f. 1195.

⁵⁰ V. Vinaver, “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë...”, f. 196.

kishte mirë punët me qeverinë shqiptare sepse akuzohej për shpërdorim fondesh gjatë periudhës kur ai ishte përfaqësues i shqiptarëve të SHBA në Londër⁵¹.

Pas njohjes së Shqipërisë nga Britania e Madhe, qeveria italiane u detyrua të deklaronte se do të njihte “de jure” dhe “de facto” qeverinë shqiptare “si qeveri e të gjithë Shqipërisë”⁵². Akti i qeverisë britanike u pasua nga njohja zyrtare e qeverisë franceze dhe një sërë qeverish të tjera⁵³.

Njohja e qeverisë shqiptare, nuk e mbylli diskutimin mbi çështjen nëse pranimi në Lidhjen e Kombeve ishte njohje zyrtare ndërkombëtare e Shqipërisë si shtet i pavarur dhe sovran. Më 27 nëntor 1921, Antonio Huneeus, që mbante detyrën e kryetarit të Komisionit V të pranimi të shteteve në Lidhjen e Kombeve, pyeti këshilltarët ligjorë të Fuqive Aleate, anëtarë të Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve, nëse pranimi në Lidhjen e Kombeve përfshinte njohjen “de jure” të Shqipërisë si shtet nga anëtarët e tjerë të Lidhjes së Kombeve. Këshilltarët ligjorë të Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve e patën të pamundur të jepnin një mendim mbi këtë çështje pasi midis tyre nuk pati një mendim të njëjtë⁵⁴.

Hapja e kësaj çështjeje në një forum ndërkombëtar si Lidhja e Kombeve, rrezikonte të nxiste shtetet e dominionit britanik të kërkonin të rishikonin statusin e tyre. Për këtë arsye, diplomacia e hollë britanike nxitoi të mbyllte sa më shpejt këtë çështje. Ekspertët e Foreign Office-it paraqitën pikëpamjen e tyre mbështetur në argumente juridike. Ata u shprehën se paragrafi 2 i artikullit 1, të Konventës së Lidhjes së Kombeve, i cili trajtonte pranimin e anëtarëve të rinj në Lidhjen e Kombeve, përcaktonte se nëse kërkesa e një shteti që kërkonte të pranohet në Lidhjen e Kombeve votohej nga një shumicë prej dy të tretash të Asamblesë së saj, ky pranim kishte kuptimin e njohjes zyrtare të këtij shteti nga të gjithë anëtarët e Lidhjes së Kombeve. Madje, edhe

⁵¹ TNA, FO 371/ 5725. Shënim i Harold Nicolson në protokollin e FO, për takimin me ambasadorin italian në Londër, FO, 14 nëntor 1921.

⁵² *Po aty*, FO 371/ 5733. Sir R. Granet për Foreign Office, Romë, 10 nëntor 1921.

⁵³ *Po aty*. Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme franceze për ambasadorin britanik lordin Hardinge në Paris, Paris, 9 nëntor 1921; *po aty*, FO 371/ 5734. Telegram i Heathcote-Smith për Foreign Office, Durrës, 14 nëntor 1921.

⁵⁴ *Po aty*, FO 371/ 5725 dhe 371/ 5729. Notë e Sir Cecil J. B. Hurst, këshilltar ligjor i Britanisë së Madhe në Lidhjen e Kombeve për Foreign Office, Gjenevë, 5 dhjetor 1921.

kundërshtimi nga një e treta e anëtarëve të Lidhjes së Kombeve nuk arrinte të bllokonte dëshirën e shumicës prej dy të tretave⁵⁵. Për këtë arsye, ata iu përgjigjën A. Huneus se pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ishte njohje zyrtare e këtij shteti.

Qëndrimi britanik ishte mjaft i rëndësishëm për konsolidimin e pozitës së qeverisë dhe të themeleve të shtetit shqiptar⁵⁶. Njohja zyrtare nga qeveria britanike i hapi dritën jeshile qeverisë shqiptare që të vendoste marrëdhënie diplomatike me një sërë qeverish të tjera. Ky akt, jo vetëm ndikoi në afirmimin ndërkombëtar të shtetit shqiptar, por njëkohësisht mundësoi që ai të kishte zërin e tij dhe të ishte më aktiv në drejtim të politikës së jashtme. Në vitet 1921-1923, qeveria shqiptare mori nismën për hapjen e përfaqësive diplomatike të Shqipërisë pranë Lidhjes së Kombeve si dhe në disa shtete me rëndësi për interesat e shtetit shqiptar⁵⁷. Njëkohësisht pranë shtetit shqiptar u akredituan përfaqësi të disa shteteve të huaja. Njohja e Shqipërisë në fushën ndërkombëtare, dëshmoi faktin se tashmë ishte forcuar vetëdija kombëtare në mesin e shqiptarëve dhe se shteti shqiptar kishte hyrë në rrugën e maturisë politike.

S u m m a r y

RELATIONS GREAT BRITAIN AND ALBANIA DURING 1920 -1922

The author of this article has been focused on some specific aspects, which further complement the overall framework of the study of British - Albanian relations. *First*, the article focuses on clarifying the political course that the United Kingdom followed towards Albania during 1920-1921; *secondly*, it contains the analytical study on the Albanian issue, submitted by John Field, an expert at Foreign Office; *thirdly*, it attempts

⁵⁵ *Po aty*, FO 371/ 5725 dhe FO 371/ 5729. Interpretim i Konventës për pranimin në Lidhjen e Kombeve [pa emër të autorit dhe pa datë].

⁵⁶ Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit – Demokracia Shqiptare në vitet 1920-1924*, botim i II-të, përkthyer nga Lindita Bubësi, Tiranë: Albin, 2003, f. 57.

⁵⁷ *TNA*, FO 371/ 7330. Robert Parr për markezimin Curzon të Kedleston, Durrës, 10 tetor 1922.

to clarify the attitude held by British diplomacy in front of Italy at the end of the Ambassadors Conference in Paris.

If we view carefully, the policy pursued by the British government to Albania, from the end of World War I until 1921, its attitude seems to have followed two lines of action. The Foreign Office continued to maintain a cold attitude ahead to Albania. A more sympathetic line to the Albanian cause was held by the representatives of the British intelligence mission on the Adriatic coast, which was dependent on the War Office. The main representatives of this mission were Colonel Aubrey Herbert, William Morton Eden and Harold Temperley, most of them worked in Albania.

Foreign Office engaged its expert, John Field, to draft a memorandum on the Albanian issue. At the end of the study, he presented three variants for the attitude that the British government could hold towards Albania. Of the three variants presented by him for resolving the Albanian case, J. Field was of the opinion that the Foreign Office had to maintain an intermediate attitude that reconciled the contents of the Ambassadors Conference's decisions in 1913 and the Memorandum of Allied Powers reached on December 9, 1919.

